



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË

Nr. ___ prot

5302/4

Tiranë më 24/12/2018

VENDIM

NR. 36 DATË. 04/12/. 2018

PËR

**MOSMIRATIMIN E KËRKESËS PËR “MIRATIMIT NË PARIM PËR PËRDORIM TË
BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE,NGA HEC VAJA,
SUBJEKTIT “CLA-AS ENERGY ” SH.P.K.**

Në zbatim të ligjit nr 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar, përkatësisht të nenit 42 pika 3; Neni 50, pika 2, neni 52 gërma c ;të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme ,dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimi për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore” si dhe të, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë object konçesioni”, neni 24, gërma “f” ndryshuar me VKM nr.718 datë 12.10.2016, me propozim të A.B.U Ishëm Erzen për paisjen me autorizim miratim në parim të subjektit “CLAS-AS ENERGY ” SH.P.K. Këshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen ,

KONSTATOJ SE,

Bazuar në diskutimin e anëtarit të Këshillit të Basenit Ujor Ishëm Erzen, përfaqësues i bashkisë Krujë,dhe shkresën e Bashkisë Krujë , Sektori i Bordit të Kullimit drejtuar Prefektit të Qarkut Tiranë rezultoi se nuk shprehin dakortësinë për ndërtimin e “Hec Vaja” pasi:

- Është pjesë e zonës së mbrojtur.
- Zhvillimi i aktivitetit të subjektit do të sillte pasoja negative për fshatrat përreth tij, prishjen e rrugëve, krijimin e pellgut ujëmbledhës i cili shkakton prishjen e habitateve dhe tokës bujqësore.
- Gryka e Vajës është Kanion, nga ku ka pikënisjen lumi i Drojës i vizituar nga shumë turistë, dhe do të shkatërrontë turizmin i cili ka vlera turistike të patjetërsueshme.
- Bashkia Krujë ka hartuar projektin për veprën e marrjes së ujit në lumin Drojë dhe furnizimin me ujë të rezervuarit të njësisë administrative Thumanë, ndërtimi i “Hec Vaja” do të cënonte funksionimin e këtij projekti.
- Prishja e habitateve të tokës bujqësore.

- Para viteve 1990 ka qënë një projekt i vjetër për ndërtimin e një Hidocentrali në këtë zonë, por është refuzuar .
- Gjatë diskutimit u konstatua se “Gryka e Vajës” është monument natyre, ndërtimi në këto zona përjashtohet kategorikisht.

Për këto arsye, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm - Erzen,

V E N D O S I:

1. Mosmiratimin e kërkesës për “miratimin në parim për përdorim të burimit ujor për energji elektrike nga **Hec Vaja** subjektit “**CLA-AS ENERGY**”sh.p.k” me administrator **Z.Geg Pirolli** për përdorim të burimit ujor përroi i Vajës, degë e Lumit të Drojës, degë e lumit Ishëm, në njësinë e qeverisjes vendore të bashkisë Krujë qarku Durrës, me këto të dhena:

- Koordinatat e veprës së marrjes **X – 44 00 356.9 Y –46 01 144.8 Z- 350**
- Godina e centralit me koordinata **X- 43 97 773.6 Y- 46 00 979.3 Z- 170**
- Prurja mesatare e përroit: **Q mes= 1,087 m³/sek;**
- Prurja ekologjike: **Q₃₅₅= 0.040 m³/sek;**
- Prurja që shkarkohet: **Q_{llog}= 1,170 m³/sek.**
- Fuqia e instaluar **E= 1580 KW**

2.Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:

- Cënohet përdorimi i ujit të pijshëm për banorët.
- Është pjesë e zonës së mbrojtur, “Gryka e Vajës” është monument natyre, ndërtimi në këto zona përjashtohet kategorikisht.
- Prishja e rrugëve të fshatrave përreth.
- Krijimi e pellgut ujëmbledhës shkakton prishjen e habitateve dhe tokës bujqësore.
- Shkatërrimin e turizmit pasi ka vlera të patjetërsueshme
- Refuzimi i një projekti para viteve 90 për ndërtimin e një Hidocentrali në këtë zonë “Gryka e Vajës” është monument natyre

3.Ngarkohet ABU Ishëm-Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Dorina ÇAPUNI



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

